



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 40, datë 28.05.2015

PËR

PËRCAKTIMIN E KOMISIONIT MAKSIMAL TË VLERËSIMIT TË DËMEVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikat 2 dhe 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 233, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Komisioni maksimal që merr vlerësuesi i pavarur i dëmit, për punën e kryer për vlerësimin e një dëmi për një ngjarje sigurimi është në vlerën 40 000 lekë.
2. Përveç komisionit të vlerësimit të dëmit, vlerësuesi ka të drejtën të marrë edhe çdo shpenzim të kryer nga ana e tij për vlerësimin e një dëmi, kundrejt dokumentit tatimor përkatës në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.
3. Komisioni i vlerësimit të dëmit i transferohet vlerësuesit të dëmeve vetëm në rrugë bankare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI